

**VENDIM**  
**Nr.741, datë 7.11.2008**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV D1”**  
**SUBJEKTIT: “TV D1” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizionë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë subjektit “TV D1” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, me afat deri më 31.12.2012 nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin e Peshkopisë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Mesila Doda (Demi)**